



AKT THEMELUES

I SHOQERISE SE RUAJTJES DHE TE SIGURISE FIZIKE

“MYRTO SECURITY” SHPK

Sot me daten 10.09.2001, ne Fier, Shqiperi

Une, Hysni MYRTAJ, i biri i Xhevilit, lindur Kreshpan Fier, me 28.02.1965, banues ne lagjen Sheq i Madh Fier, mbajtes i pasaportes Nr.0562350, leshuar nga komisariati i policise Fier, mbeshtetur ne ligjin Nr.7512, date 10.08.1991, ligjen 7638, date 19.11.1992, ligjen Nr.8770, date 19.04.2001 “Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike” si dhe ne legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, me cilesine e Ortakut te Vetem Themelues, kam vendosur per sa me poshte vijon:

Neni 1

Te themeloj nj Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (SHPK), per te zhvilluar veprimtari ne perputhje me ligjet: Nr 7512, date 10.08.1991, Nr.7638, date 19.11.1992, dhe ligjin Nr.8770, date 19.04.2001, qe ka te beje me: -- Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personae fizik e juridik, qe ushtrojne veprimtarine ne Republiken e Shqiperise.

--Sigurimi dhe mbrojtja e jetes dhe e shendetit te shtetasve vendas dhe te huaj.

-Shoqeria per te permbushur misionin e vete ,ka te drejte te vendos mjete dhe sisteme vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive, paisje nderlidhjeje, si dhe te perdore teknika te tjera, duke respektuar legjislacionin ne fuqi.


Per ruajtjen e objekteve ,shoqeria mund te perdore edhe qen sherbimi, duke marre masat perkatese per parandalimin e pasojave qe mund te sjelle ky lloj sherbimi.

Neni 2

Shoqeria do te emertohet: Shoqeria e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike “MYRTO SECURITY” Shpk.

Neni 3

Shoqeria do te kete seline ne adresen Lagjia “ KASTRIOT” prane Telekomit Fier. Ne baze te nenit 5, pika 2 e ligjit 8770, date 19.04.2001


"Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike" Shoqeria ka te drejte te ushtrojve veprimtarine ne te gjithe teritorin e Republikes Shqiperise.

Neni 4

Objekti i Shoqerise do te jete kryerja e Sherbimeve te Kategorive (a+b):
--Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personae fizik e juridik, qe ushtrojne veprimtarine ne Republikën e Shqiperise.
--Sigurimi dhe mbrojtja e jetes dhe e shendetit te shtetasve vendas dhe te huaj.
Shoqeria per te permbushur misionin e vete ,ka te drejte te vendos mjete dhe sisteme vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive, paisje nderlidhjeje, si dhe te perdore teknika te tjera, duke respektuar legjislacionin ne fuqi.
Per ruajtjen e objekteve ,shoqeria mund te perdore edhe qen sherbimi, duke marre masat perkatese per parandalimin e pasojave qe mund te sjelle ky lloj sherbimi.

Neni 5


Kohezgjatja e Shoqerise eshte fiksuar deri me 31 Dhjetor 2011 dhe mund te zgjatet ose te priset me perpara me vendim te Ortakut te Vetem Themelues.

Neni 6

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte percaktuar ne 4.000.000 (kater) milion leke. Ky kapital eshte neneshkruar dhe shlyer si me poshte:
■ 4.000.000 (kater) milion leke, ne emer te Hysni MYRTAJ, baras me 100% te kapitalit te Shoqerise.

Neni 7

Viti financiar do te mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik. Viti i pare financiar do te mbyllet me 31.12.2001. Ortaku i Vetem Themelues kujdeset qe brenda kufijve dhe ne zbatim te normave ligjore te hartoje inventarin dhe bilancin te perbere nga gjendja pasurore, llogaria ekonomike dhe nga llogarite plotesuese duke i shoqeruar ato me nje relacion mbi ecurine e administrimit te Shoqerise.



Mbi te ardhurat neto qe rezultojne nga bilanci i vitit financiar do te zbritet nje kuote jo me pak se 5% per tu shenuar si rezerve ligjore.

Neni 8

Administrimi i Shoqerise dhe perfaqesimi ligjor i saj i besohet Ortakut te Vetem Themelues **Z.Hysni MYRTAJ**.

Drejtimi Teknik i saj behet nga **Z.Arben HAXHIAJ**.

Qysh nga ky cast vendoset qe te gjitha derdhjet e kapitalit te kryhen ne monedhe te vendit ashtu dhe fitimet dhe financimet eventuale te ardheshme nga Ortaku i Vetem themeluse ,ose nga te tretet,si dhe te gjitha arketimet qe kane te bejne me shitjen e Shoqerise,duhet te derdhen ne nje llogari qe do te hapet prane nje banke ne Fier.

Neni 9

Ky akt u hartua ne kater kopje identike e me te njejten vlere.

ORTAKU THEMELUES

Hysni MYRTAJ

